

INFORMACION PËRMBLEDHËS I  
RRJETIT POP  
PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

JANAR - QERSHOR 2022

# BULETIN INFORMATIV

JANAR - QERSHOR 2022

POP - PËRBALLJA  
E OFERTAVE  
POLITIKE



# ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE 2022

Në datë 6 mars 2022 në Shqipëri u organizuan zgjedhjet e pjeshme vendore nëgjasthtë bashki të vendit, dy prej të cilave ishin bashkia Durrës dhe ajo e Shkodrës, bashki këto nën monitorimin e Rrjetit POP që prej përpilimit të Kontratës Socialenë vitin 2019 dhe zbatimit të saj nga bashkitë.

Edhe në këto zgjedhje, anëtarët e rrjetit POP njësoj si gjatë zgjedhjeve të tjerat lokale organizuan takime individuale dhe forume publike me kandidatët e Partive Politike duke iu ofruar atyre një platformë, ku të mund të shpalosnin programet e tyre politike për zhvillimin e bashkive respektive në prani të qytetarëve.

Në bashkinë Durrës, Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) organizoi tre forume publike në kuadër të Kontratës Sociale dhe po njësoj në bashkinë Shkodër, Intelktualët e Rinj Shpresë organizuan dy forume publike me praninë e kandidatëve dhe qytetarëve.

## Rrjeti POP DHE KONTRATAT E REJA NË DURRËS DHE SHKODËR

Tashmë në Durrë dhe Shkodër kemi dy kontrata të reja sociale të cilat po monitorohen nga organizatat partnere dhe janë bërë pjesë e planeve të punës së bashkive respektive.



[Kliko për tu njohur me Kontratën Sociale Durrës](#)



[Kliko për tu njohur me Kontratën Sociale Shkodër](#)





# ADVOKOJMË PËR KONTRATËN SOCIALE

Gjatë periudhës së parë të vitit u organizuan takime me qytetarët dhe përfaqësues 12 bashkive ku Rrjeti POP operon. Qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutimi i analizës së Raportit të Vitit të dytë monitories të Kontratës Sociale si edhe identifikimi i problematikave të qytetarëve si dhe angazhimi i tyre për të advokuar pranë pushtetit vendor.

Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile aleatë të fortë për advokimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. Nxjerrim në pah prioritete të cilat nuk janë adresuar nga bashkitë respektive dhe llojshmëri për përfshirjen e tyre në projektet e pushtetit vendor.

## 60 takime me grupet qytetare dhe grupe interesi nga bashkia dhe media

[Kliko](#) për tu njohur me takimet sipas bashkive nën monitorim dhe organizatave zbatuese





# POP NË JAVËN EVROPIANE 2022


Rrjeti POP mori pjesë në aktivitetet e organizuara nga Delegacioni Evropian në Shqipëri në kuadër të Javës Evropiane. Pjesëmarrja në këto aktivitete u bë e mundur nga ftesa dhe mbështetja e Ambasadës Suedeze në Shqipëri.

Ishim në Shkodër në 3 datë maj 2022; Vlorë në datë 5 maj 2022 dhe e përmbyllëm në Tiranë në datë 9 maj 2022

Gjatë panairëve të organizuara në pedonalet e të tre qyteteve patëm mundësinë që të shkëmbejmë me qytetarët dhe grupet e interesit arritjet dhe sfidat në përmbushjen e Kontratës Sociale dhe prioritetëve të saj në 12 bashkitë e vendit.

**3 panairë; 12 organizata; mbi 1000 qytetarë vizituan stendat tona në 3 bashki**

[Kliko për të lexuar Kontratën Sociale](#)





# RJETËZIM ME ORGANIZATAT E RAJONIT



Gjatë javës së parë të muajit qershor në kuadër të OPC Network Meeting organizuar në Tiranë në datat 31 maj – 1 qershor 2022, kishim kënaqësinë dhe mundësinë të takonim organizata të rajonit të cilat mbështeten nga Olof Palme International Centre dhe që punojnë mbi forcimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Kishim mundësinë që të shkëmbejmë eksperiencat për punën që secila prej organizatave bën me komunitetin në rajon si edhe prezantimin e metodologjisë së POP dhe Kontratës Sociale që prej vitesh po zhvillohet në Shqipëri.

Biseduam së bashku mbi arritjet, sfidat, situatën në Shqipëri dhe Rajon si edhe punën e organizatave të shoqërisë civile për mbështetjen dhe angazhimin e qytetarëve, rritjen e transparencës nga pushteti vendor dhe qendror si edhe planet për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë.

Gjithashtu, rrjeti POP ishte pjesë e panelit mbi edukimin qytetar ku patëm mundësinë të analizonim metodologjinë si edhe të diskutonim mbi sfidat që hasen gjatë zhvillimit të saj.





# RAPORTI STUDIMOR "INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR



Tiranë

Fier

Durrës

Korçë

**12 Raporte individuale në lidhje me mekanizmat që përdorin bashkitë për informimin dhe konsultimin qytetar.**

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj - qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.



Pogradec

Kamëz

Vlorë

Pukë

Kukës

V.Dejës

Elbasan

Shkodër

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira nën monitorim. Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash.

Raportet mund të lexohen sa më sipër dhe do të prezantohen edhe në Konferencën Kombëtare "Rrjeti POP dhe Kontrata Sociale si mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve" që parashikohet të organizohet në muajin korrik 2022.



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” me mbështetjen e Qeverisë Suedeze dhe “National Endowment for Democracy.”

### Anëtarët e Rrjetit POP:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave
- Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

**Për çdo pyetje, kërkesë apo detaje të tjera në lidhje me rrjetin POP, kontaktoni në:**

**E-mail:** [perballjaeofertavepolitike@gmail.com](mailto:perballjaeofertavepolitike@gmail.com)

**Mob:** +355 (0) 69 61 20 169

**Na ndiqni në kanalet tona zyrtare:**

**Web:** [popnetwork.al](http://popnetwork.al)

**Facebook:** [POPNetworkAlbania](https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania)

**Twitter:** [POPAlbania2020](https://twitter.com/POPAlbania2020)

**Instagram:** [pop\\_perballjaeofertavepolitike/](https://www.instagram.com/pop_perballjaeofertavepolitike/)

**You tube:** [perballjaeofertavepolitike](https://www.youtube.com/channel/UC...)



Klikoni imazhin për të ndjekur videon e përgatitur nga Rrjeti POP në lidhje me Kontratën Sociale

